



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

**VENDIM**

Nr. 23, Datë 27/07/2016

**PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 27.07.2016 në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të VKM 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre” si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Vlorë.

**VENDOSI :**

1. Të miratojë Vendimin Nr. 22, datë 02.06.2016 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues *Znj. Farije Sorraj (subjekti Z. Veli Sherif Sorraj «trashëgimtarët e tij me gjeneralitetet e subjektit sipas certifikatës së vitit 1991»* për një objekt banimi (1 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 82.5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe truall funksional 150 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “24 Maji“, rruga “Enver Jaho” të qytetit të Vlorës, zona kadastrale 8604, nr. pasurie 7/96 që kufizohet nga Veriu me pasurinë me nr. 7/99 Thoma Sema, Jugu me pasurinë nr.7/95 Selvi Sorraj, nga Lindja me pasurinë nr. 7/237 Shtet (rrugë) dhe nga Perëndimi me pasurinë 7/2371 Shtet (rrugë).
2. Të miratojë Vendimin Nr. 23, datë 02.06.2016 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues *Z. Isuf Feimi (subjekti Z. Isuf Feimi dhe Afërdita Feimi « gjeneralitetet e subjektit sipas certifikatës së vitit 1991»*, për një objekt banimi (1 kat) me sipërfaqe ndërtimi 70 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe truall funksional 150 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “24 Maji“, rruga “Mis Durhan” të qytetit të Vlorës, zona kadastrale 8604, nr. pasurie 15/50/2 që kufizohet nga Veriu me pasurinë 15/50/1 I zoti, Jugu me pasurinë nr. 15/50/4 Gani Feimi , nga Lindja me pasurinë nr. 15/50/3 Ali Feimi (posedues Naim Feimi) dhe nga Perëndimi me pasurinë nr. 15/50/1 I zoti.
3. Të miratojë Vendimin Nr. 27, datë 28.06.2016 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1981 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues *Bashkë pronësi Muho (subjekti Bashkëpronësia Muho « gjeneralitetet e subjektit sipas certifikatës së vitit 1991»*, për një objekt banimi (1 kat) me sipërfaqe ndërtimi 70.0 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe truall funksional 121.0 m<sup>2</sup>, me